



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 15 (827870)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 12 prill 2024

Ministri Peleshi: Përkushtimi ynë ndaj vlerave euroatlantike, i pandryshuar, garant për paqen dhe stabilitetin në rajon



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji, mori pjesë në ceremoninë e betimit të 139 ushtarëve të rinj në Regjimentin e Këmbësorisë së Jugut në Poshnjë, Berat.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, ishin të pranishëm gjithashtu edhe zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, komandanti i Qendrës së Personel Rekrutimit, kolonel Fadil Ciroku, drejtues të pushtetit vendor dhe lokal, oficerë, nënoficerë, ushtarë, etj.

SHSHPFA gjeneralmajor Arben Kingji e cilësoi ceremoninë e betimit ushtarak si një ditë të veçantë në karrierën e ushtarakut, një akt dhe premtim solemn për besnikëri ndaj Kushtetutës së RSH, për t'i shërbyer dhe mbrojtur deri në vetëmohim Atdheun. "...Kjo është një ditë e shënuar edhe për Regjimentin e Këmbësorisë së Jugut dhe për Forcat e Armatosura, pasi shtohen në radhët tona ushtarakë të edukuar, të motivuar, të përgjegjshëm për detyrat që u ngarkohen dhe që kultivojnë respektin për eprorët dhe shokët..."

Më tej, gjeneralmajor Kingji gjatë fjalës së tij, pasi solli në vëmendje faktin se ceremonia përkon edhe me 15-vjetorin e anëtarësimit të vendit tonë në NATO, një ngjarje e shënuar për vendin dhe Forcat e Armatosura, u shpreh ndër të tjera se: "Objektivi ynë ka qenë dhe mbetet mbajtja e kapaciteteve operacionale ushtarake të nevojshme për të garantuar sigurinë në vend, përgjegjësia në kuadër të mbrojtjes kolektive dhe në këtë drejtim në linjë me Direktivën e Ministrisë të Mbrojtjes dhe vizionit të SHSHPFA edhe gjatë këtij viti do të vijojë puna për realizimin e projekteve të modernizimit dhe implementimit të strukturës së re, duke përfshirë dhe elementin rezervist, përmirësimin

Gjeneralmajor Arben Kingji: Betimi ushtarak, një akt dhe premtim solemn për besnikëri ndaj Kushtetutës së RSH, për t'i shërbyer dhe mbrojtur deri në vetëmohim Atdheun



SHSHPFA gjeneralmajor Arben Kingji e cilësoi ceremoninë e betimit ushtarak si një ditë të veçantë në karrierën e ushtarakut, një akt dhe premtim solemn për besnikëri ndaj Kushtetutës së RSH, për t'i shërbyer dhe mbrojtur deri në vetëmohim Atdheun.

e kuadrit ligjor me qëllim trajtimin më të mirë të personelit, finalizimin e strategjisë ushtarake dhe Planin Afatgjatë të Zhvillimit '24-'33, si dhe rritjen e kontributit në operacionet e drejtuara nga NATO".

Duke përfunduar, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Arben Kingji u shpreh besimplotë për dinamizmin dhe gjallërinë që ushtarët e rinj do i japin punës në strukturat ku do të shërbejnë.



Efektivi i Regjimentit të Mbështetjes me Luftim zhvilloi marshim dhe qitje luftarake

Në zbatim të plan-kalendarit të aktiviteteve kryesore, planit të marshimeve dhe qitjeve luftarake, efektivi i Regjimentit të Mbështetjes me Luftim në Forcën Tokësore kreu një marshim taktik 7 km në rrugëkalimin Çakallë - Qafëlopë - Poligoni i Qitjes.

Ky marshim u zhvillua në tre faza ajo e planëzimit, e zhvillimit të marshimit dhe realizimit të qitjes. Qëllimi i këtij marshimi ishte rritja e kompaktësisë dhe qëndrueshmërisë së trupave në lëvizje për në rajonin e përqendrimit, marrjen e detyrës luftarake dhe realizimit të qitjes me armët individuale.

Gjatë lëvizjes u improvizuan situata të ndryshme sipas listë-detyrave themelore të reparteve, si: situatë të mbrojtjes nga MADM, kontrollin e shtigjeve të kalimit, masat e ruajtjes dhe veprimet në rast goditje nga artileria etj.

Pas përfundimit me sukses të dy fazave u realizua qitje luftarake me armët individuale.



Përfundon kursi bazë i oficerit në specialitetin Këmbësori

Në mjediset e Qendrës Stërvitore në Komandën e Forcës Tokësore Zall-Herr, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë të Oficerit në specialitetin Këmbësori. Në këtë kurs u trajnuan 33 ushtarakë. Në këtë ceremoni mori pjesë Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, shefi i Shtabit të FT-së, kolonel Beqir Tafili, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ekland Dauti etj. Në fjalën e tij përshëndetëse, komandanti i Forcës Tokësore gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, pasi falënderoi oficerët e rinj për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar u ndal në kujdesin që ata duhet t'i kushtojnë përgatitjes profesionale, si kusht bazë për përparimin në karrierën e oficerit si dhe kujdesin e shtuar që po tregon Ministria e Mbrojtjes dhe lidërsia e Forcave të Armatosura për trajtimin sa më të mirë të personelit ushtarak dhe në veçanti për oficerët e rinj të FA-së. Ky kurs u zhvillua në një periudhë 4 mujore, ku kursantët morën njohuri të plota mbi togën, rolin dhe detyrat që kryen ajo në lloje të ndryshme luftimi: në procesin e drejtimit të trupave, dhënieve të domosdoshme për drejtimin operacional të togës në operacionet luftarake, jo luftarake e paqeruajtëse; marrjen e njohurive bazë në specialitet ushtarakë përkatëse, marrjen e njohurive bazë për armët dhe shërbimet në FA si dhe në dhënieve të njohurive për menaxhimin dhe analizën pas stërvitjes. Në Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore nga muaji janar i këtij viti deri më sot janë zhvilluar një sërë kursesh, si KBO specialiteti Zbulim dhe Këmbësori, KBNOF, Kursi Komando, kursi "Junior Command and Leadership Course" si dhe tre grupe mësimore të gjuhës angleze, në total 120 kursantë. Gjithashtu vijojnë KAO, KANOF, KBOF.



Ministri Peleshi: Përkushtimi ynë ndaj vlerave euroatlantike, i pandryshuar, garant për paqen dhe stabilitetin në rajon

Me rastin e 15-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, Komanda e Forcës Tokësore në Zall Herr zhvilloi "Ditën e Hapur", ku morën pjesë Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Sh. T. z. Bajram Begaj, njëherësh Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i Ngarkuari me Punë i Ambasadës së SHBA-së David Wisner, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, ministra, deputetë, ambasadorë, atashë ushtarakë, komandantë të forcave, etj. Fillimisht të pranishmit ndoqën demonstrimet e kryera nga efektivet e Forcës Tokësore dhe trupat komando, ndërsa vizituan standat e Forcave të Armatosura, ku u prezantuan pajisjet dhe kapacitetet për mbrojtjen dhe sigurinë, sistemet e komunikimeve taktike, operacionale dhe strategjike.

Në fjalën përshëndetëse me këtë rast ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u shpreh se: "15 vjet më parë, në shpërbim të vullnetit absolut të popullit shqiptar, të etjes properëndimore të një vendi të çliruar nga izolimi total, Shqipëria u anëtarësua si vend me të drejta të plota në NATO, aleancën më të madhe politiko-ushtarake që këtë vit mbushi 75 vjet; një arritje kjo e jashtëzakonshme jo vetëm në kuptimin politik dhe diplomatik, por gjithashtu në kuptimin më të plotë të nocionit mbi sigurinë dhe mbrojtjen. U dhamë qytetarëve tanë mundësinë e mbrojtjes nga Aleanca më e madhe politiko-ushtarake e të gjitha kohërave dhe kjo nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen e 26 vendeve aleate të NATO-s, asokohe". Ministri Peleshi falënderoi vendet aleate për këtë vendim, ndërsa shprehu mirënjohjen për aleatin strategjik SHBA-në, që qëndroi krah Shqipërisë në çdo hap të rrugëtimit drejt Aleancës.

Sipas ministrit të Mbrojtjes, sot kontributi i Shqipërisë respektohet e vlerësohet lart nga vendet mike dhe partnere, por vlerësim të veçantë ka për vendosmërinë që Shqipëria ka, për të qenë kudo ku Aleanca ka nevojë.

"Përfaqësohemi me elitën e Forcave të Armatosura në krahun juglindor në Bullgari dhe Letoni si dhe kemi një prezencë të konsiderueshme ushtarake në KFOR, Kosovë, aktivitetet detare në detin Egje dhe misionin trajnuar në Irak.

Ndërkohë djemtë dhe vajzat më të mira në uniformë, por edhe të tjerë kolegë të shërbimit civil shërbejnë me një profesionalizëm të spikatur në përfaqësinë tonë në Bruksel si dhe në shtabet dhe komandat e NATO-s në hapësirën euroatlantike", - u shpreh ministri i Mbrojtjes Peleshi.

"Tashmë, 15 vite më pas, besoj se kemi hyrë në një fazë tjetër të rolit tonë në Aleancë. Nuk ka më asnjë dyshim në vendosmërinë tonë në kontribute, në qasje dhe në qëndrime. Ne zgjedhim të jemi me aleatët tanë në çdo sfidë që kohët e turbullta, me të cilat po përballet njerëzimi do të na imponojnë. Ne qëndrojmë fort në krah të Ukrainës, popullit të saj, përpjekjeve të ushtrisë së saj për të përballuar agresionin e egër rus. Kemi ndihmuar dhe do të vijojmë të ndihmojmë popullin e Ukrainës në luftën e tij të drejtë për liri. Do të vazhdojmë gjithashtu të jemi garantët më luajalë të paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë", - theksoi ministri Peleshi.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi vuri theksin te inaugurimi i bazës ajrore taktike të NATO-s në Kuçovë, por edhe projekti për Porto Romanon, për ta vënë atë në dispozicion të Aleancës.

Nga ana e tij, Presidenti Bajram Begaj theksoi se: "Angazhimi ynë ndaj NATO-s është i pakushtëzuar dhe tregon se jemi të gatshëm të marrim pjesë jo vetëm për mbrojtjen e kufijve tanë, por edhe për të ndihmuar e kontribuar në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon e më gjerë".

Kreu i Shtetit e cilësoi anëtarësimin në NATO jo destinacion, por si një udhëtim të vazhdueshëm të Shqipërisë, - siç u shpreh ai, për të forcuar demokracinë, investimet në kapacitetet mbrojtëse, si dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë



për të ndërtuar një të ardhme më të sigurt e më të qëndrueshme për të gjithë. Presidenti Begaj përcolli një falënderim të veçantë ndaj Shteteve të Bashkuara për ndihmën e vazhdueshme dhe ndërhyrjen e NATO-s për çlirimin e Kosovës, duke u shprehur: "Kombi shqiptar nuk do ta harrojë kurrë këtë".

I ngarkuari me punë në ambasadën e SHBA-së, David Wisner, duke cituar fjalët e Presidentit George W. Bush, theksoi fuqinë e qëndrueshme të Aleancës: "Forca e qëndrueshme e aleancës

së NATO-s është një testament për fuqinë e qëndrueshme të lirisë. Kjo Aleancë do të udhëheqë rrugën drejt një bote më të sigurt dhe më shpresëdhënëse. Shpresoj që fëmijët tuaj t'i nderojnë gjithmonë betejat që keni përballuar. Qofshin historitë e Shqipërisë dritë për ata që mbeten në errësirë e tiranisë. Dhe shpresoj që shembulli juaj le t'i ndihmojë ata drejt një ditë më të ndritshme", - u shpreh përfaqësuesi i SHBA-ve.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së,

gjeneralmajor Arben Kingji u shpreh se: "Vlerësimet pozitive që marrin Forcat tona të Armatosura në stërvitjet, operacionet apo strukturën e komandimit të NATO-s, përforcojnë përkushtimin tonë për të realizuar me sukses detyrën dhe për të zhvilluar më tej bashkëpunimin me vendet aleate dhe partnere". Në përfundim të aktivitetit të pranishmit përshëndetën në një lidhje live efektive që shërbejnë në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare.

Komandanti i FA-së, gjeneral brigade Ferdinand Dimo mori pjesë në Simpoziumin e Shefave Ajrorë të NATO-s në Ramstein, Gjermani

Gjatë Simpoziumit I të Shefave Ajrorë të NATO-s (NATO Air Chiefs' Symposium - NACS) në 2024, udhëheqja e lartë nga forcat ajrore aleate, NATO dhe organizatat ndërkombëtare, u mbledhën për të diskutuar se si të përmirësohen operacionet e integruara në fuqinë ajrore dhe hapësinore të NATO-s dhe gjithashtu përkujtuam 75-vjetorin e Aleancës.

Në vijim, u diskutuan çështje që lidhen me luftimin ajror në operacionet e përbashkët, praktikat e reagimit të menjëhershëm, ndryshimi i strukturës së komandimit dhe kontrollit ajror, zëvendësimi i konceptit të patrullimit ajror me shtimin e kapaciteteve të mbrojtjes ajrore nga toka (SMAMD), si dhe shtimi i kapaciteteve të ndarjes dhe shkëmbimit të informacionit. Me rëndësi ishte edhe bisedimi i rritjes së kapaciteteve hapësinore si pasojë e ndryshimeve gjeostrategjike. Komanda



ajrore aleate ka pritur për disa vite simpoziume gjashtëmuore të shefave ajrorë të NATO-s. Ato janë një vend për shkëmbimin e pikëpamjeve për përfaqësuesit e lartë të forcave ajrore të shteteve



anëtare të NATO-s dhe ofrojnë një mundësi për të vlerësuar situatën dhe për të diskutuar bashkëpunimin, koordinimin dhe zhvillimin e fuqisë ajrore dhe hapësinore të NATO-s.

Shqipëria 15-vjet në NATO, Gjeneralmajor Shehu: Krenarë që jemi pjesë e organizatës më të fuqishme politike-ushtarake të globit

Komanda e Forcës së Bashkuar të NATO-s në Napoli kremtoi 75-vjetorin e krijimit të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, “Të mbrojmë çdo centimetër të Aleancës”, me këtë rast Komanda e Forcës së Bashkuar të NATO-s në Napoli zhvilloi disa aktivitete në të cilat morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë ushtarak nga vendet anëtare të NATO-s, ambasadorë dhe të ftuar specialë nga vendet dhe strukturat e NATO-s. Shqipëria u përfaqësua në këtë aktivitet nga një delegacion i kryesuar nga zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu.

Komandanti i Forcës së Bashkuar të NATO-s në Napoli dhe njëkohësisht Komandant i Forcave Detare të SHBA për Evropën dhe Afrikën, Admiral Stuart B. Munsch, pasi bëri një përshkrim të shkurtër të historikut të NATO-s, theksoi rëndësinë dhe arritjet e saj gjatë periudhës 75-vjeçare në kontribut jo vetëm për sigurinë e Aleancës, por edhe për sigurinë dhe paqen në botë. “Ne sot ndihemi krenarë që NATO, si organizata më e fuqishme e sigurisë në botë, ka treguar se është e aftë jo vetëm të garantojë sigurinë e vendeve aleate, por të promovojë sigurinë dhe paqen kudo në botë, duke u angazhuar në një sërë operacionesh kurdoherë që ka qenë e nevojshme. Ne sot jemi të aftë të mbrojmë çdo centimetër të Aleancës”.

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admiral Rob Bauer, duke vlerësuar kontributin e të gjithë vendeve anëtare në formësimin e NATO-s si një organizatë të qëndrueshme dhe mbartëse të vlerave perëndimore, theksoi se: “Ne jemi që fuqishëm se e njohim dhe kemi besim tek njëri-tjetrit, në dallim nga kundërshtarët tanë. Ne jemi të fortë, sepse NATO nuk është thjesht një organizatë ushtarake, por bashkon vlerat e të gjithë



popujve tanë, ku çdo shtetas ndihet krenar dhe i vetëdijshëm për kontributin e tij”.

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu në takim me Komandantin e Komandës së Forcës së Bashkuar të NATO-s, pasi e falënderoi për organizimin e aktivitetit, theksoi rëndësinë e Aleancës për sigurinë e rajonit tonë. “Shqipëria sot feston gjithashtu 15-vjetorin e anëtarësimit në NATO dhe ndihemi krenarë që bëjmë pjesë në organizatën më të fuqishme politike-ushtarake të globit. Kontributi ynë besoj është një vlerë e shtuar në Aleancë dhe pjesëmarrja jonë në të gjitha angazhimet e aleancës është tregues i qartë i vendosmërisë së lidershit politik dhe ushtarak ndaj rrugëtimit tonë drejt vlerave perëndimore”. Aktiviteti vijoi me një ceremoni të zhvilluar në bordin e anijes flamurtare të flotës VI SHBA, USS “Mount Whitney”, si dhe një koncert nga bandat e 10 shteteve anëtare të NATO-s, ku motoja e muzikës ishte: “Duke mbrojtur çdo centimetër të Aleancës”.

15 efektivë të Bazës së Mbështetjes së Emergjencave Civile përfundojnë Kursin I të Kërkim - Shpëtimit Malor

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse, u zhvillua ceremonia e certifikimit të 15 kursantëve efektivë të Bazës së Mbështetjes së Emergjencave Civile, të cilët përfunduan me sukses Kursin I të Kërkim - Shpëtimit Malor.

Ky kurs u zhvillua për një periudhë tre javore dhe kishte si qëllim përvetësimin e njohurive dhe aftësimin e kursantëve në veprime praktike për përdorimin e pajisjeve individuale dhe kolektive të ndërhyrjes në operacione të kërkim - shpëtimit malor.

Në këtë ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit i Komandës Mbështetëse, kolonel Idriz Kuca, dhe komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla.

Kolonel Zyla në fjalën e tij të rastit, nënvizoi faktin se në një të ardhme të afërt kursantët që ndjekin kurse të tilla do të pajisen me dëshmi aftësie, gjë e cila do të shërbejë edhe në jetën civile.

Kursi i sapo përfunduar do të pasohet me kurse të tjera në të cilët do të merren njohuri më të avancuara për perfeksionimin e teknikave për t'u aftësuar për pjesëmarrje në operacione.

Kolonel Kuca, në fjalën përmbyllëse, falënderoi kursantët dhe instruktorët për përkushtimin e treguar gjatë zhvillimit të kursit, ku ndër të tjera theksoi mbështetjen e vazhdueshme për vijimin e trajnimeve dhe stërvitjeve të mëtejshme, për përgatitjen e personelit të Forcave të Armatosura dhe jo vetëm.



Në përfundim të ceremonisë, të gjithë kursantët u pajisën me certifikatë për përfundimin me sukses të trajnimit dhe certifikatë mirënjohjeje morën edhe instruktorët për kontributin e tyre.



Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen viziton institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes në Prishtinë, Kosovë

Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen KLSM-14, nën koordinimin e stafit drejtues të kryesuar nga gjeneral brigade Ylli Pulaj, në vizitën akademike tre ditore në institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës së Kosovës, zhvilloi takime zyrtare në Komisionin Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Ministrinë e Mbrojtjes, komandën e KFOR-it si dhe Kompleksin Memorial "Adem Jashari".

Gjatë ditës së parë gjeneral brigade Ylli Pulaj, stafi akademik dhe pjesëmarrësit në KLSM-14 u pritën në Komisionin Parlamentar për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes nga z. Bekë Berisha kryetar dhe anëtarë të tjerë deputetë në Parlamentin e Kosovës. Në këtë takim u diskutua mbi prioritetet e sigurisë kombëtare, bashkëpunimet aktuale si dhe rruga drejt anëtarësimit në NATO.

Në sesionin e pasdites, pjesëmarrësit e KLSM-14, vizituan Ministrinë e Mbrojtjes, ku u pritën nga zëvendësministri i Mbrojtjes z. Shemsi Sylja, i shoqëruar nga drejtori i Drejtorisë së Inteligjencës dhe Sigurisë gjeneralmajor Gëzim Hazrolli. Fillimisht, zëvendësministri Sylja, iu uroi mirëseardhjen dhe më pas i informoi lidhur me proceset dhe sfidat nëpër të cilat po kalon Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, ecurinë e zbatimit të Planit Gjithpërfshirës së Tranzicionit të FSK-së, etj. Gjithashtu, zëvendësministri Sylja u shpreh lidhur me situatën e sigurisë në vend, rajon dhe më gjerë si dhe ndikimin e saj në aspektin global të sigurisë. Në përfundim të ligjëratës, pjesëmarrësit e KLSM-14 adresuan pyetje të ndryshme për temat e diskutuara gjatë takimit.



Gjeneral brigade Ylli Pulaj u prit në takime të veçanta nga komandanti i KFOR-it, gjeneral major Özkan Ulutaş dhe nga zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Federiko Bernacca, ku bashkëbiseduan mbi situatën operacionale në vend,

duke u ndalur në nivelin e sigurisë pas ngjarjeve të fundit në veri të Kosovës si dhe bashkëpunimet e duhura të njëjve ushtarake të nivelit lartë me qëllim ruajtjen e paqes dhe sigurisë.

Gjatë ditës së tretë, pjesë e programit akademik, ishte dhe ndalesa në Kompleksin Memorial "Adem Jashari", kushtuar familjes së Heroit të Kosovës Adem Jashari në Prekaz të Poshtëm të Drenicës. Pjesëmarrësit panë nga afër shtëpitë e shndërruara në muze, varret e të rënëve në luftë të familjes Jashari, dëgjuan mbi historinë e familjes dhe sulmet e kryera ndaj shtëpisë së tij në mars të vitit 1998, si dhe me vënien në mbrojtje të kësaj zone me interes të veçantë me rëndësi ontologjike, antropologjike, historike dhe kulturore.

Kjo vizitë akademike i njohu akoma më shumë pjesëmarrësit me organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës së Kosovës si dhe iu dha mundësi të marrin njohuri mbi veprimtarinë e tyre, rëndësinë e bashkëpunimit mes shteteve të rajonit për të zgjidhur mosmarrëveshjet, promovuar paqen dhe sigurinë në rajon si dhe angazhimin e BE-së dhe NATO-s, për të mbështetur proceset e integritetit dhe stabilizimit.



Programi akademik vijoi me vizitë në komandën e KFOR-it, Prishtinë, ku stafi drejtues dhe grupi mësimor u pritën nga zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Federiko Bernacca, i cili iu uroi mirëseardhjen dhe i përgëzoi pjesëmarrësit për mundësinë e ndjekjes së këtij kursi të nivelit strategjik. Në vijim, me anë të prezantimeve nga përfaqësues të degës së zbulimit, operacioneve dhe planifikimit, pjesëmarrësit u njohën me organizimin, detyrat dhe sfidat aktuale të ndërveprimit të kësaj baze të NATO-s me rëndësi në Republikën e Kosovës.



KLO, vizitë në Komisionin e Sigurisë Kombëtare të Kuvendit të Shqipërisë

Kursantët e kursit të Lartë të Oficerit në vijim të programit mësimor, shoqëruar nga Departamenti i Strategjisë dhe Studimeve të Avancuara zhvilluan vizitë mësimore në Komisionin e Sigurisë Kombëtare të Kuvendit të Shqipërisë. Gjatë bashkëbisedimit me deputetet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, njëkohësisht anëtarë të Komisionit të Sigurisë Kombëtare znj. Antoneta Dhima dhe znj. Pranvera Resulaj, kursantët u njohën me organizimin dhe mënyrën e funksionimit të këtij komisioni me rëndësi në strukturën e Kuvendit të RSH.



Kursantët e KKSHP-së përfunduan stërvitjen planëzuese "Skatina-2024"

Kursantët e kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) zhvilluan stërvitjen planëzuese për vendimmarrje në vendkomandë, "Brigada e këmbësorisë në luftimin mbrojtës, "Skatina-2024". Kjo stërvitje u realizua me skenar fiktiv sipas programit mësimor për periudhë dyjavore në formë teorike dhe praktike në terren (në rajonin Peshkopi-Kukës-Has-Tropojë-Fushë Arrëz-Pukë-Gjegjan), duke zbatuar termat doktrinar dhe skemat në përputhje me doktrinat dhe manualët e NATO-s. Kursantët gjatë stërvitjes u aftësuan për kryerjen e Procedurave të Vendimmarrjes Ushtarake në rolet e oficerëve koordinues dhe specialistë në përbërje të shtabit të një brigade këmbësorie të mekanizuar, duke vepruar si Forcë e Bashkuar. Stërvitja u ndoq nga



afër dhe nga komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Ylli Pulaj si dhe përfaqësues nga drejtoria e Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.



Stoltenberg: Finlanda e merr seriozisht sigurinë dhe mbrojtjen

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Vetëm disa ditë pasi Finlanda festoi përvjetorin e parë të pranimit të saj në Aleancë, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg mirëpriti, më 10 prill 2024, Presidentin finlandez Alexander Stubb në selinë e NATO-s.

Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi kontributet e shumta të Helsinkit në NATO, dhe tha se Finlanda e merr seriozisht sigurinë dhe mbrojtjen dhe se ajo ka bërë prej kohësh prioritet shpenzimet e mbrojtjes. “Ne jemi mirënjohës për faktin se kur Finlanda u bashkua me NATO-n, një tjetër aleat i NATO-s po shpenzon më shumë se 2% për mbrojtjen. Ju keni personel të trajnuar shumë dhe aftësitë tuaja të avancuara ushtarake forcojnë parandalimin dhe mbrojtjen tonë”, - tha ai. Stoltenberg falënderoi gjithashtu Finlandën për mbështetjen e saj të vendosur ndaj Ukrainës, mbështetje e cila arrin në rreth 2 miliardë euro ndihmë ushtarake që nga viti 2022, dhe përshëndeti përfundimin e një marrëveshjeje sigurie 10-vjeçare të Finlandës me Kievin.

Sekretari i Përgjithshëm theksoi urgjencën e mbështetjes së vazhdueshme ushtarake për Ukrainën në një situatë të vështirë në fushëbetje. “Vonesat në financim po sjellin pasojat e drejtpërdrejta në terren çdo ditë”, - tha ai. “Vonesat në shpërndarjen e mbrojtjes ajrore do të lejojnë raketat ruse të godasin më shumë objektiva, dhe vonesat në dërgimin e municioneve do t'i lejojnë Rusisë të bëjë presion përgjatë vijës së frontit. Ukraina thjesht nuk mund të presë. Ajo ka nevojë për mbrojtje ajrore, municione dhe ndihmë. Tani!”

Stoltenberg nënvizoi se: “NATO po punon në mënyrë aktive për të siguruar ndihmë të besueshme dhe të parashikueshme të sigurisë për Ukrainën tani dhe për një kohë të gjatë”.

Finlanda, rreth 2 miliardë euro ndihmë ushtarake për Ukrainën që nga viti 2022

Duke i uruar mirëseardhjen në selinë e NATO-s dhe urimet për zgjedhjen si President i Finlandës, Sekretari i Përgjithshëm përgëzoi Alexander Stubb për përvjetorin e parë të Finlandës si një aleat i plotë i NATO-s. “Anëtarësimi juaj e bën NATO-n më të fortë dhe Finlandën më të sigurt. Finlanda e merr seriozisht sigurinë dhe mbrojtjen”, - vlerësoi Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, që në hyrje të deklaratsës së tij në konferencë e përbashkët për shtyp me Alexander Stubb, Presidentin e Finlandës. “Prej kohësh i keni bërë prioritet shpenzimet e mbrojtjes dhe ne jemi mirënjohës për faktin se kur Finlanda u bashkua me NATO-n, një tjetër aleat i NATO-s po shpenzon dhe më shumë se 2% për mbrojtjen. Ju keni personel të trajnuar shumë dhe aftësitë tuaja të avancuara ushtarake forcojnë parandalimin dhe mbrojtjen tonë”, - tha Stoltenberg. Integrimi i pandërprerë i Finlandës në familjen e NATO-s dhe strukturat e NATO-s pasqyron dekada të bashkëpunimit shumë të ngushtë midis Finlandës si një partner i mëparshëm, përpara se ajo të bëhej një anëtar i plotë. “Ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku për të forcuar më tej Aleancën tonë. Ne jetojmë në një botë më të rrezikshme, por NATO është bërë më e fortë, kështu që ne vazhdojmë të mbrojmë dhe sigurojmë të gjithë aleatët”.

Sekretari i Përgjithshëm dhe presidenti finlandez në takimin e tyre diskutuan Ukrainën dhe nevojën urgjente për më shumë mbështetje. “Mbështetje të besueshme dhe të parashikueshme për Ukrainën, sepse situata në fushën e betejës është e vështirë. Vonesat në financim po sjellin pasojat e drejtpërdrejta në terren çdo ditë. Vonesat në dërgimin e mbrojtjes ajrore do të lejojnë raketat ruse të godasin më shumë objektiva, dhe vonesat në dërgimin e municioneve do t'i lejojnë Rusisë të bëjë presion përgjatë vijës së frontit. Ukraina thjesht nuk mund të presë. Ajo ka nevojë për mbrojtje ajrore, municione dhe ndihmë. Tani! Kundër të gjitha gjasave, ukrainasit kanë arritur tashmë kaq shumë. Ata mund të triumfojnë, por kanë nevojë për mbështetjen tonë”, - tha Shefi i NATO-s.

NATO po punon në mënyrë aktive për të siguruar ndihmë të besueshme dhe të parashikueshme të sigurisë për Ukrainën tani dhe për një kohë të gjatë, në mënyrë që Ukraina të mbështetet më pak në kontributet vullnetare dhe më shumë në angazhimet e NATO-s. Më pak për ofertat afatshkurtra dhe më shumë për premtimet shumëvjeçare. “Moska duhet të kuptojë se ukrainasit nuk mund t'i presin ata dhe, për rrjedhojë, një paketë për Ukrainën me mbështetje të fuqishme të parashikueshme është ajo për të cilën ne po punojmë tani në NATO”, - tha Sekretari i Përgjithshëm dhe falënderoi Presidentin për mbështetjen e fortë të Finlandës për të rritur mbështetjen e NATO-s për Ukrainën.

“Më lejoni gjithashtu të falënderoj Finlandën dhe ju për faktin se që nga pushtimi i plotë i Ukrainës, në vitin 2022, Finlanda ka qenë një mbështetëse e vendosur e Ukrainës. Ju keni dhënë rreth 2 miliardë euro ndihmë ushtarake që nga viti 2022, duke përfshirë 30 milionë euro për nismën e artilerisë të udhëhequr nga Çekia. Unë mirëpres gjithashtu që vetëm javën e kaluar Finlanda nënshkroi një marrëveshje të re 10-vjeçare sigurie me Kievin. Pra, ne jemi mirënjohës për kontributet tuaja në



mbrojtjen kolektive të NATO-s, për sigurinë tonë të përbashkët dhe, jo më pak e rëndësishme, që Finlanda është një vend kryesor në ofrimin e mbështetjes për Ukrainën”.

Mbështetja për Ukrainën është e palëkundur, ajo ka të drejtë të vetëmbrohet

Finlanda nuk ka vendosur asnjë kufizim për ndihmën e saj ushtarake për Ukrainën. Kurse disa vende të NATO-s ende nuk lejojnë që armët e tyre të përdoren për të goditur territorin rus, ndërkohë që lufta vazhdon aftësia e Ukrainës për të fituar luftën ka nevojë për mbështetje. Nga ana tjetër zëvendës Presidenti i BE-së Josep Borrell, tha, më 9 prill, se “Evropa duhet të përgatitet për një luftë të mundshme, pasi një konflikt në shkallë të gjerë në kontinent nuk është më një fantazi”. Lidhur me se, sa i rëndësishëm është roli i Finlandës ndërkohë që Evropa përgatitet kundër këtij kërcënimi të Rusisë, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha për gazetaret se kurrë nuk mund ta marrim paqen si të mirëqenë dhe se jetojmë në një botë më të rrezikshme.

“Ne kemi një luftë të plotë në Evropë. Kemi një luftë të re në Lindjen e Mesme dhe kemi më shumë rivalitet të fuqive të mëdha. Në të njëjtën kohë, ne kemi parë që NATO është përshtatur. Pra, ne jetojmë në një botë më të rrezikshme, por NATO është bërë më e fortë për të ruajtur paqen, për të parandaluar luftën, siç ka bërë NATO me sukses për 75 vjet”. Por megjithatë Stoltenberg tha se “ne nuk shohim ndonjë kërcënim të afërt, një kërcënim ushtarak kundër çdo aleati të NATO-s, sepse parandalimi i NATO-s funksionon”, - tha ai.

“Aleatët janë së bashku dhe një sulm kundër njërit do të jetë një sulm ndaj të gjithëve dhe kjo është mënyra më e mirë për të parandaluar çdo sulm të armatosur ndaj çdo aleati të NATO-s”. Ai tha është vendim i secilit aleat se çfarë lloj mbështetjeje saktësisht ofron për Ukrainën, por ai tha se mirëprehet që aleatët kanë ofruar raketa me rreze të gjatë. “Aleatët po ofrojnë gjithashtu tani F 16 dhe ne duhet të kujtojmë se çfarë është kjo: Kjo është një luftë agresioni ku Rusia ka pushtuar një vend tjetër, duke shkelur hapur ligjin ndërkombëtar. Dhe Ukraina ka të drejtën sipas ligjit ndërkombëtar për vetëmbrojtje. Kjo është në fakt një e drejtë, e sanksionuar në Kartën e OKB-së. Dhe ne kemi të drejtë të ndihmojmë Ukrainën të ruajë të drejtën e vetëmbrojtjes pa i bërë aleatët e NATO-s palë në konflikt”.

Ukraina, tha Sekretari i Përgjithshëm, përveç pjesës të vetëmbrojtjes, ajo ka të drejtë të godasë objektiva legjitime ushtarake jashtë Ukrainës për t'u mbrojtur. “Pra, kjo është një luftë shkatërrimi, Ukraina ka të drejtën për vetëmbrojtje dhe unë e mirëpres që aleatët po ofrojnë mbështetje ushtarake për të mundësuar vetëmbrojtjen e tyre”, - tha Stoltenberg.

Kurse Presidenti finlandez Alexander Stubb lidhur me mbështetjen për Ukrainën, tha se ndërsa një pesimist gjithmonë përgatitet për më të keqen, një optimist sigurohet që ajo të mos ndodhë. “Mendoj se kjo është pikërisht ajo që ne duhet të bëjmë. Së pari për sa i përket mbrojtjes kombëtare, së dyti, për sa i përket mbrojtjes së NATO-s dhe së treti, për sa i përket kapacitetit të Bashkimit Evropian”. Për sa i përket mbështetjes finlandeze për Ukrainën, ajo është e palëkundur, tha ai, dhe se ajo do të vazhdojë për aq kohë sa të duhet. “Nga vizita ime në Kiev javën e kaluar, mendoj se mesazhi ishte shumë i qartë për të gjithë aleatët tanë, përfshirë Shtetet e Bashkuara, është se Ukraina ka nevojë për municione. Ajo ka nevojë për armë, ka nevojë për automjetet dhe ka nevojë për tani. Pra, ka një nevojë afatshkurtes për ndihmë dhe kjo është arsyeja pse unë i kam bërë thirrje gjithashtu Kongresit të SHBA-së që të lirojë 60 miliardë dollarët sepse kjo është pjesë e paketës”, - tha Presidenti finlandez. “A do t'i zgjidhë të gjitha kjo? Jo. Ne duhet të

vazhdojmë të bëjmë pjesën tonë edhe në Evropë dhe kjo është arsyeja pse unë mirëpres iniciativën çeke për grumbullimin e municioneve. Ai tha se Belgjika ka angazhuar 200 milionë euro për këtë iniciativë të veçantë dhe theksoi se mënyra më e mirë për të siguruar që lufta të mos ndodhë në tokën tonë, është duke mbështetur Ukrainën tani”.

Nga ana tjetër, aleatët e NATO-s kanë ofruar një nivel të paprecedentë mbështetjeje për Ukrainën, duke përfshirë mbrojtjen ajrore, bateritë Patriot, si dhe gjithashtu sisteme të tjera të avancuara, duke përfshirë NASAMS, IRIS-T, SAMP-T dhe sisteme të tjera të mbrojtjes përpara. “Po aq e rëndësishme sa dërgimi i sistemeve të reja është të sigurohet që sistemet që janë tashmë atje funksionojnë ashtu siç duhet, që do të thotë se kanë nevojë për pjesë rezervë, kanë nevojë për municione, kanë nevojë për mirëmbajtje”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, lidhur me mbrojtjen ajrore dhe bateritë Patriot.

Ai tha se në takimin e ministrave të jashtëm javën e kaluar, mesazhi i tij ishte njëjtë me atë të shumë aleatëve se ekziston nevojë për të rritur edhe më shumë dhe për të siguruar jo vetëm municione dhe pjesë këmbimi për bateritë ekzistuese dhe sisteme por edhe për të ofruar më shumë sisteme. “Unë e di se disa aleatë tani me të vërtetë po shohin se çfarë mund të bëjnë më shumë, se si mund të gërmojnë edhe më thellë në inventarët e tyre për të siguruar më shumë mbrojtje ajrore për Ukrainën, sepse është urgjente”, - tha Sekretari i Përgjithshëm.

Duke folur për mbështetjen, Presidenti finlandez Stubb tha se Finlanda ka lëshuar paketën e 23-të të ndihmës, që nga viti 2022. “Ndihma jonë ushtarake në afërsisht 2 miliardë, e kombinuar me zhvillimin humanitar, 900 milionë të tjera shtojnë faturën tonë në 2.9 në këtë fazë. Zakonisht ne, themi më pak dhe bëjmë më shumë, por këtë herë lëshuam edhe dy forma të pajisjeve ose municioneve materiale ushtarake që i dhamë Ukrainës. Njëra ishte në fakt mbrojtje ajrore dhe tjetra ishte municione të rëndë. Finlanda është në fakt GDP e gjashtë për frymë e matur në drejtim të mbështetjes së Ukrainës dhe ne do të vazhdojmë ta bëjmë këtë. Unë mendoj se të gjithë ne e kuptojmë jo vetëm shtetet e vijës së parë, por të gjithë ne në Evropë e kuptojmë se është në interesin tonë të vazhdojmë ta bëjmë këtë”, - tha Presidenti Stubb.

Finlanda në pritje të një Komande të Komponentit Tokësor

Mediat në Finlandë kanë shkruar se do të ketë një Komandë të Komponentit Tokësor në Mikkeli, nën drejtimin e Norfolk JFC. Lidhur me cilat janë përfitimet e NATO-s dhe cilat janë përfitimet për Finlandën që të ketë këtë njësi në territorin e saj Presidenti finlandez Alexander Stubb tha për gazetaret se ka një ambicie politike për të pasur një komandë të tillë dhe më pas kjo ambicie politike pasohet me një vendim, por, tha ai “ende nuk është marrë asnjë vendim, pasi pritet që SACEUR të përcaktojë se cilat janë interesat ushtarake dhe të mbrojtjes të Aleancës, të Finlandës dhe vendeve të tjera nordike, dhe nëse do të jetë nën Norfolk apo Brunsum. Pas kësaj tha ai duhet të ketë një vendim ushtarak që të përcaktojë se cili është vendi më i mirë për mbrojtjen ajrore, cili është vendi më i mirë për mbrojtjen detare dhe cili është vendi më i mirë për mbrojtjen tokësore. “Ne po punojmë me aleatët tanë për zgjidhjen më të mirë, e cila ka shumë pak të bëjë me politikën rajonale, shumë pak me politikën, por është thjesht një vendim ushtarak. Por nuk mendoj se duhet të kesh një doktoraturë në strategjinë ushtarake për të kuptuar se nëse kufiri tokësor i Aleancës është dyfishuar me Rusinë, mund të jetë mjaft e dobishme të kesh ndoshta edhe një Komponent Tokësor afër atij kufiri”, - tha presidenti finlandez.

Ndërsa Sekretari i Përgjithshëm tha se NATO e mirëprehet faktin që Finlanda ka ofruar të presë Komandën e Komponentit Tokësor për një forcë me shumë trupa, por edhe ai tha se për këtë ende nuk është marrë asnjë vendim. Ndërkohë pritet këshilla nga Komandanti Suprem i Aleatëve SACEUR dhe në bazë të kësaj NATO do të marrë një vendim brenda disa javësh ose disa muajsh. “Sa i përket mënyrave të ndryshme që ne tani do të përshtatim strukturën tonë komanduese, kjo ka të bëjë pjesërisht me faktin se ne kemi Finlandën dhe Suedinë si anëtarë të rinj, por edhe faktin që ne në fakt kemi iniciuar një proces më të madh të përshtatjes së strukturës komanduese të NATO-s dhe një pjesë e saj do të ketë gjithashtu komanda të ndryshme të komponentëve në pjesë të ndryshme të Evropës, duke përfshirë zonën nordike”, - tha Stoltenberg.

“Lidhur me raportet e ditëve të fundit se intelijenca ushtarake ukrainase ka kryer një sulm ndaj një luftanijeje ruse të ankoruar në Kaliningrad, dhe nëse konsiderohet si legjitime që Ukraina të kryejë sulme ndaj anijeve luftarake ruse në Baltik, veçanërisht duke pasur parasysh se Baltiku tani shpesh përshkruhet si një liqen i NATO-s”, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha se: “së pari nuk do të hyj në specifika kur bëhet fjalë për intelijencën. Dhe së dyti, unë nuk do të jap këshilla specifike se çfarë lloj objektivash duhet ose nuk duhet të sulmojë Ukraina, përveçse të them se është pjesë e së drejtës për vetëmbrojtje edhe të godasësh objektiva legjitime ushtarake jashtë vendit tënd. Për shkak se Rusia po përdor kaq shumë lloje të ndryshme aftësish për të sulmuar Ukrainën dhe Ukraina ka të drejtën për vetëmbrojtje, dhe kjo përfshin gjithashtu objektiva legjitime ushtarake jashtë Ukrainës”.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Një grua e fortë shkund botën në themele dhe lë gjurmë të përherëshme në univers

A duhet mbledhur forca vetëm për të kaluar nëpër këtë botë të çmendur?! Amy Tenney do thoshte: “Bota ka nevojë për gra të forta, gra që do të duan dhe do të duhen, gra që jetojnë me guxim, si të brishta dhe të ashpra, gra të vullnetit të pamposhtur”.

Por, a e kanë zotëruar tashmë artin e të jetuarit sipas kushteve të tyre, gratë?

Ato mund të na tregojnë mësimet të vlefshme për të qenë të durueshëm përballë vështirësive dhe për t'u lartësuar mbi pengesat që jeta mund t'i verë përpara.

Çfarë do të thotë në të vërtetë të jesh një grua e fortë, dhe çfarë i vendos këto gra larg të tjerëve?

Ato nuk i pranojnë broçkullat e askujt. Ato qëndrojnë të gjalla vetë dhe nuk lejojnë askënd që t'ua “presë krahët”. Ato e dinë vlerën e tyre dhe nuk lejojnë që dikush ta ndrydhë atë.

Respekti ndaj vetes, arma e fortë në betejën e ashpër të ‘Vaterlosë’

Një grua e fortë e respekton veten mjaftueshëm sa për të mos u trajtuar si një portier, dhe ajo i jep të njëjtin respekt të tjerëve. Ajo e di se të gjithë meritojnë të kenë një zë dhe të dëgjoen, ajo pret që njerëzit t'i tregojnë asaj të njëjtën mirësjellje.

Në vend që të shqetësohet kur njerëzit nuk e trajtojnë atë ashtu siç dëshiron të trajtohet, ajo thjesht bëhet një person edhe më i madh dhe i vret me mirësinë e saj. I duhet shumë pjekuri një personi që të përballlet dhe të mos lejojë sjelljen e njerëzve të tjerë ta tërheqin poshtë. Gruaja e fortë vazhdon të habitë njerëzit me mençurinë dhe ‘përulësinë’ e saj. Ajo gjen ekuilibrin e duhur mes arrogancës dhe mungesës së vetëbesimit, sepse ajo kërkon respekt, por nuk gjen në të një kompleks superioriteti.

Me fjalë të tjera, ajo i trajton të gjithë në mënyrë të barabartë si veten dhe pret të njëjtën gjë nga të tjerët.

Prindërit e saj e mësuat atë që me një roje të sillet në të njëjtën mënyrë si me një njeri me post të lartë. Dhe kjo është njerëzorja ...

Të jetë e pavarur

Ajo nuk ka nevojë për ndonjë mashkull apo femër për ta ndihmuar të ecë përpara në jetë. Do të ishte më mirë për të që t'i kryejë vetë gjërat se sa të zhgënjehet prej dikujt tjetër. Ajo ka standarde të larta për veten. Ju do ta shikoni atë duke realizuar qëllimet e saj vazhdimisht, sepse ajo nuk dëshiron që kur të kthejë pas kokën në jetën e saj, të shohë me keqardhje.

Gratë e forta shpesh janë ngritur me “mentalitetin e fituesit”, që do të thotë se prindërit e tyre i shohin ato si arritëse të larta, të cilat mund të arrijnë një marrëveshje të madhe për veten e tyre. Ato janë edukuar për madhësinë, gjë që e bën të vështirë për gratë e forta t'i lejojnë të tjerët t'i ndihmojnë.

Ato me të vërtetë nuk mendojnë se kanë nevojë për ndihmë, duke bërë që ato të marrin përsipër më shumë nga sa mund të përballojnë. Në këtë mënyrë pavarësia është një shpatë me dy tehe. Lum kush di cilën anë të zgjedhë? Nëse jeni një grua e fortë, përpuni të kuptoni dobinë e të lejuarit të vetes për të pasur nevojë për të tjerët.

Një grua e forte di si t'i kontrollojë emocionet

Një grua e fortë e di fuqinë e mendjes dhe nuk lejon që ajo t'i kontrollojë jetën. Ajo i merr nën zotërim emocionet dhe nuk lejon që ato të qeverisin rrugëtimin e saj. Kjo grua e di se emocionet ndryshojnë vazhdimisht, ashtu si moti, kështu që ajo nuk i jep shumë vlerë ëndjes në situata apo ndjenja. Ajo i lejon vetes të ndjejë emocionin dhe më pas vazhdon përpara.

Ajo nuk lejon që njerëzit apo ngjarjet të diktojnë mënyrën se si ndihet ajo. Në vend që t'i lërë të tjerët të kontrollojnë energjinë e saj, ajo vendos energjinë e saj mbi gjithë të tjerët.

Ajo lë gjurmë të qëndrueshme tek njerëzit e tjerë, sepse ajo e di se çfarë dëshiron të shfaqë në tavolinë në çdo situatë të caktuar. Ajo nuk lejon që frika apo dyshimet të kontrollojnë energjinë e saj, sepse ajo e di se këto emocione nuk do ta lejojnë atë të arrijë rezultatin e dëshiruar.



Ajo e sheh jetën më shumë si një lojë. Për të fituar, gruaja e fortë e di se ajo duhet të jetë vetja e saj më e mirë gjatë gjithë kohës. Ajo vendos një fytyrë të guximshme dhe fiton mbi çdo gjë që qëndron në rrugën e saj dhe e bën këtë me një gjendje mendore të ekuilibruar dhe nën kontroll.

Një grua e fortë merr përsipër rreziqet

Gruaja e fortë e di se kur duhet të ndërmarrë rreziqe. Ajo e di se jeta kërkon që ne ta nxisim veten përpara nëse duam të rritemi dhe të mësojmë.

Ajo merr rreziqe në mënyrë që të ketë një formim më të mirë dhe të testojë limitet e saj. Kjo grua e di se shumë nga kufijtë mund të kalohen në qoftë se ne kapërcejmë së pari pengesat mendore.

Ndërsa jemi fëmijë, ne besojmë se mund të bëjmë gjithçka, sepse prindërit dhe edukatorët na thonë se mundemi. Ne nuk kemi frikë, sepse programimi i botës nuk na ka prekur ende.

Nëse ne rrëzohemi dhe lëndohemi si fëmijë, nuk fiksohemi pas ngjarjes dhe nuk lejojmë që frika të rritet në ne. Ne thjesht përballemi me frikën tonë pa pushim derisa të mësojmë se si ta mposhtim atë.

Fëmijët i jepen momentit aktual sepse kanë mendje të hapura. Ata duan të absorbojnë gjithçka që mund t'u mësojë jeta. Pastaj, kur rritemi, fillojmë të vendosim mure dhe t'i tregojmë vetes se nuk mund të bëjmë gjëra të caktuara. Ne formojmë një imazh të vetes në kokat tona, i cili bëhet identiteti ynë.

Pas një kohe, ne bëhemi fikse. Ne nuk besojmë që ne mund të përulemi dhe t'i përshtatemi diçkaje të re. Megjithatë, gruaja e fortë e thyen shpesh këtë cikël. Ajo e shtyn veten të bëjë gjëra të reja në mënyrë që identiteti i saj dhe vetë-imazhi të mos ngurtësohen.

Ajo nuk e lejon frikën që ta kontrollojë atë, sepse ajo nuk mund të mësojë nëse nuk është e qetë dhe e sigurt.

Ruan pozitivitetin

Mendimi pozitiv qëndron në ballë të mendjes së saj, sepse ajo e di se nuk mund të udhëheqë një jetë pozitive me një pikëpamje negative ndaj botës. Një grua e fortë e di se pozitiviteti mund të ndryshojë jetën e dikujt, ajo mund t'i nxjerrë ato nga thellësia e dëshpërimit deri në lartësimin e ndjenjës së gëzimit.

Prandaj, gruaja e fortë përdor fuqinë e të menduarit pozitiv në jetën e saj të përditshme. Ajo nuk i lejon retë të bllokojnë diellin e saj, në vend të kësaj bëhet burimi i dritës. Për shembull,

nëse ajo ka humbur punën kohët e fundit, ajo nuk lejon që të menduarit negativ të krijojë në të besimin se ajo kurrë nuk do të gjejë ndonjë punë tjetër.

Ndoshta do të ishte më mirë pa atë punë. Ndoshta nuk e donte aq shumë sa mendonte ajo. Ajo shikon drejt të ardhmes dhe beson se do të gjejë diçka më të mirë. Duke shfaqur këtë energji, ajo e di se do të ketë një shans shumë më të mirë për t'i kthyer mendimet e saj në realitet.

Kjo grua nuk fiksohet pas problemeve, në vend të kësaj ajo fokusohet në zgjidhjen e tyre. Gruaja e fortë vëren se çfarë mund të bëjë për të përmirësuar situatën e saj, siç është kërkimi i vendeve të punës dhe kërkesa për mbështetës për të parë nëse ato mund ta ndihmojnë.

Ajo e di se çfarë dëshiron nga jeta dhe nuk ka frikë të shkojë pas asaj gjëje. Një grua e fortë i pëlqen t'i ketë gjërat nën kontroll, por e di kur është koha që dikush tjetër duhet të udhëheqë. Ajo është krijuese dhe përdor imagjinatën e saj për të krijuar realitetin e saj. Asaj nuk i pëlqejnë dramat apo thashetheme dhe largohet nga njerëzit që angazhohen në këto sjellje të cekëta.

Ato nuk zbkurojnë asgjë

I tregojnë gjërat ashtu siç janë dhe presin që njerëzit e tjerë të bëjnë të njëjtën gjë. Gratë e fuqishme kujdesen për shëndetin dhe lumturinë e tyre dhe nuk presin që të tjerët ta bëjnë këtë për ta. Ato kanë nevojë për shumë kohë për të risjellë energjinë e tyre pasi ato japin kaq shumë prej vetes në baza ditore.

Një grua e fortë e rrethon veten me njerëz pozitivë. Ajo nuk është e dhënë pas njerëzve negativë. Ato vazhdimisht duan të mësojnë gjëra të reja dhe të provojnë limitet e tyre. Ato kanë një mendje të hapur dhe besojnë se mund të bëjnë gjithçka në jetë. Ajo nuk lejon që dikush ta manipulojë. Ajo i di vlerat e saj dhe nuk beson se duke e mbajtur gojën mbyllur nuk do të shkaktojë probleme.

Gratë e forta janë njerëz të veçantë që sjellin ndryshime të mëdha në këtë botë. Ato kanë një vizion dhe nuk ndalen derisa ëndrrat e tyre të bëhen realitet. Për to jeta është shumë e shkurtër për t'u kthyer në versionin më të vogël të vetvetes. Kjo jam unë dhe ti ‘mikja ime’ që në itinerarin e jetës tënde nuk lejove askënd të të mbajë ‘për dore’, sa herë u rrëzove aq herë u ngrite më e fortë, me kokën lart dhe hapin e sigurt.



PRILLI I PARA 8 VITEVE U NDAL NË GJYSMË, PRANVERËN E RE NUK DO E SHIJONIN MË DY DJEMTË E RINJ, “SHQIPONJAT E QIELLIT”, FLORIANI DHE DONALDI. DËSHMORËT E ATDHEUT”, KAPITEN FLORIAN DELIA DHE TOGER DONALD HOXHA RANË NË KRYE TË DETYRËS TETË VITE MË PARË, SI PASOJË E RRËZIMIT TË HELIKOPTERIT EC -145 NË MALËSINË E MADHE, GJATË NJË FLUTURIMI STËRVITOR.

Atdheu përjetë mirënjohës

“Dëshmorët e Atdheut”, kapiten Florian Delia dhe toger Donald Hoxha ranë në krye të detyrës tetë vite më parë, si pasojë e rrëzimit të helikopterit EC -145 në Malësinë e Madhe, gjatë një fluturimi stërvitor. Prilli i para 8 viteve u ndal në gjysmë, pranverën e re nuk do e shijonin më dy djemtë e rinj, “shqiponjat e qiellit”, Floriani dhe Donaldi.

Kapiten Floran Delia lindi më 01.10.1973 në Dibër. Kreu studimet në akademinë ushtarake “Skënderbej” nga ku u diplomua në vitin 1996 në specialitetin “Oficer Aviacioni”. Nga viti 2004 e në vazhdim ka kryer detyra të ndryshme në Repartin e Farkës, si pilot ekuipazhi i parë në BO105 dhe komandant ekuipazhi SAR. Kapiten Delia ka kryer kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit. Kapiten Delia ishte i martuar me 3 fëmijë.

Toger Donald Hoxha u lind më 17.06.1988 në Berat. Kreu Akademinë e Aviacionit të Pozzuolit në Napoli, Itali, ku e përfundoi me sukses në vitin 2011 dhe u certifikua si pilot. Pas shkollimit, u emërua si pilot në Forcën Ajrore dhe më pas në Bazën Ajrore të Farkës, ku dhe shërbeu nga viti 2012 me profesionalizëm e devotshmëri. Detyra e fundit e toger Hoxhës ishte “pilot (SAR)” në Grupin e Helikopterëve në Bazën Ajrore të Farkës.

Kreu kurse të ndryshme kualifikimi, brenda dhe jashtë vendit, për pilotimin e helikopterëve të tipit EC145 (SAR).

Sot dhe përgjithmonë ne do kujtojmë dëshmorët tanë, inspirimin e brezave në vite.

Dëshmorët janë ndërgjegjja më sublime dhe vetëdija e ngritur lart, deri në piedestalin e vetëflijimit. Breza të tërë pas nesh do i kujtojnë ata!

Dëshmorëve u këndohen këngë trimërie, si këto fjalë zemre që në vijë melodike vijnë për dëshmorët tanë:



*Nga Trupi po prapë
Shfaqet një ylber
Flamuri kuq e zi valëvitet në erë
Është komandant Hoxha
Mbi helikopter
Legjendë e vendit
Do mbetesh përherë
Aty në ballkon ka mbetur nëna
Me buzët që dridhen për djalin e saja
Me mision u nise për të fundit herë*

*Bashkë me Florianin ju mbetët në qiell
Ata që të njohin të kujtojnë me mall
Dëshmorët e atdheut, përjetë jeni gjallë
Një shembull i ndritur
Për brezat që vijnë
Atdheut që deshët ia rritët lavdinë*

Kujtimet e vetme që kemi për dëshmorët janë përmendoret, lapidarët dhe kujtesa historike që na bën të jemi krenarë. I përjetshëm kujtimi i bijve tanë!



Mujo Ulqinaku ishte ndër luftëtarët e parë më të shquar, i cili, më 9 prill të vitit 1939, organizoi qëndresë të armatosur kundër pushtimit fashist italian. Heroi i Popullit, Mujo Ulqinaku lindi në Ulqin, në familjen e një detari të varfër, në vitin 1896. Që në moshë të vogël hyri ndihmës detar dhe më vonë punoi si detar në Shkodër e në Durrës. Me gradën e nënofficerit në një nënrepart të marinës në Durrës, ditën e agresionit fashist italian kundër Shqipërisë u vu menjëherë në krye të detarëve të braktisur nga oficerët tradhtarë dhe organizoi me ta e me vullnetarë të tjerë qëndresën e armatosur në portin e Durrësit.

Mujo Ulqinaku luftoi me trimëri e guxim të rrallë, duke vrarë e plagosur dhjetëra fashistë. Ra në luftim të pabarabartë në mbrojtje të atdheut, më 7 prill 1939, duke u bërë shembull i lartë patriotizmi e atdhedashurie. Në mëngjesin e 7 prillit 1939, ushtria fashiste italiane, prej 35 - 40 mijë vetash e sulmoi Shqipërinë, duke zbarkuar në Durrës, në Vlorë, në Shëngjin dhe në Sarandë. Në Durrës, ushtria e vogël shqiptare e drejtuar nga kapteri i marinës Mujo Ulqinaku i bëri qëndresë pushtuesit.

Ushtarët italianë zbarkuan në bregun e Durrësit, por u detyruan të zbrapseshin në det mbasi në breg i priti mitralozi i Mujo Ulqinakut që mbronte trojet e veta. Ushtarët italianë zbarkuan disa herë në breg dhe po aq herë edhe u zbrapsën. Por ushtria italiane ishte e shumtë në numër dhe Mujua nuk mund t'i bënte ballë për shumë kohë veçse sa qe gjallë, ata nuk kaluan dot. Në këtë mbrojtje të truallit të vet Mujo Ulqinaku ra heroikisht dhe u bë kështu dëshmor i parë i atdheut në luftë kundër pushtuesit fashist. Aktit heroik të Mujo Ulqinakut i kushtohet busti i vendosur pranë kullës së kalasë së Durrësit, emrin e tij e mbajnë rrugë, anije, shkolla etj.

Burimet e kohës bëjnë të ditur se qytetarët e Durrësit thoshin se italianët kishin lënë katërqind të vrarë, ndërsa italianët deklarojnë se në tërë Shqipërinë kishin humbur vetëm 12 vetë. Por është e qartë se vetëm në Durrës u vranë rreth 200 italianë dhe 700 në të gjithë Shqipërinë. Sikurse numri i shqiptarëve të vrarë ka qenë ndoshta edhe më i madh. Në portin e Vlorës nuk pati ndonjë qëndresë të madhe, por trupat motoçikliste italiane ranë në pritë në rrugën jashtë qytetit, ku pësuan humbje në njerëz. Zbarkimi në Shëngjin u kundërshtua nga një grup jo më shumë se prej 40 vetash, gjatë luftimeve pati 6 ose 7 të vrarë, prej secilës palë. Tashmë rruga për në Tiranë ishte e lirë nga të gjitha drejtimet.

Zhvillimet në Shqipëri në prag të pushtimit fashist

Më 8 janar të vitit 1939, kryetari i Qeverisë fashiste, Benito Musolini, miratoi planin e Çianos për pushtimin ushtarak të Shqipërisë. Ahmet Zogu mori disa masa kundër planeve italiane. Ambasadori italian në Tiranë protestoi për këto masa. Ndërkohë, në Italinë e Jugut u përqendruan forcat ushtarake që do të realizonin pushtimin.

Më 25 mars 1939, Ahmet Zogut iu paraqit një projekt traktat nga qeveria italiane që synonte nënshkrimin e Shqipërisë. Por Ahmet Zogu e la në heshtje. Pasi iu përsërit më 2 prill, iu paraqit ultimatum i afat deri në orën 12 të datës 6 prill.

Më 5 prill 1939, Qeveria Shqiptare i paraqiti ministrit italian në Tiranë kundërpropozimet, në të cilat kërkohej të përfundohej një konventë ushtarake dhe të përcaktohej rrethanat kur ushtria italiane mund të vendosej në Shqipëri.

Më 6 prill pasdreke, parlamenti shqiptar e hodhi poshtë ultimatumin e B. Musolinit. Populli shqiptar e ndjeu rrezikun e pushtimit. Ai shpërtheu në demonstrata dhe i kërkoj qeverisë të organizonte qëndresën. Demonstruesit shkuan përpara pallatit mbretëror në Tiranë për të kërkuar armë. Gatishmërisë së kosovarëve për t'u ardhur në ndihmë vëllezërve të tyre,

Qeveria Jugosllave iu kundërvu me mbylljen e kufijve. Zogu nuk mbathi opingat dhe nuk ngjeshi armët për ta mbrojtur Shqipërinë

“ MUJO ULQINAKU LUFTOI ME TRIMËRI E GUXIM TË RRALLË, DUKE VRARË E PLAGOSUR DHJETËRA FASHISTË. RA NË LUFTIM TË PABARABARTË NË MBROJTJE TË ATDHEUT, MË 7 PRILL 1939, DUKE U BËRË SHEMBULL I LARTË PATRIOTIZMI E ATDHEDASHURIE.

sikur kishte premtuar, por mbathi këpucët e modës italiane dhe së bashku me krejt familjen e gjerë, me arin e tubuar dhe me disa adjutantë besnikë iku tinëz si një hajn nga Atdheu i pushtuar. Fillimisht u vendos në Greqi e prej andej në Evropë.

Ja si e përshkruan okupimin fashist të Shqipërisë publicisti francez, Hubert Bouchet

E pashë të vdesë Shqipërinë, Durrësi u zgjua këtë mëngjes të së premtës së shenjtë si zakonisht. Në port ishin ankoruar dy anije të vogla të përhirta, me pamje peshkaqeni dhe që mbanin flamurin e Madhërisë së Tij, Perandorit të Italisë e të Etiopisë. Të tjera anije, në det të hapët, disa milje larg po patrullonin si me pamje të pafajshme...

... Befas, një skuadrilje ajrore, grupuar si patat e egra që mërgojnë, kalon gjithë gumëzhimë në lartësi të ulët, duke shurdhuar zonën me bubullimën e mijëra kuajve fuqi në oshtimë. Të jetë vallë një sinjal? Kryqëzorë e silurues shfaqen në horizont me ndriçime të kuqërremta. Topi gjëmon. Grykat 380 mm të marinsave vjellin vdekjen nga mitralozat mbi shtëpitë e bëra në shumicën e tyre me qerpiç e dërrasa. Por edhe shtëpitë prej guri nuk është se rezistojnë më shumë përballë atij shiu të plumbitë e të çeliktë. Popullsia, që në shumicën e saj merret me peshkim, me toruan krejt të humbur pyet, në këtë të premtë të shenjtë përse qielli po zëmërohet dhe po u dërgon zjarrin e skëterrës. Të jetë vallë fundi i botës? Aspak, është thjesht dëshira e Zotërisë Musolini që po vihet në jetë. Kërkon ta vërë Shqipërinë në hap, se na qenka vend mesjetar, me zakone barbare, me mbret tradhtar (Duce dixit!).

Gratë, me ferexhetë që fluturojnë nga era, rendin sa djathtas, majtas, duke kërkuar një strehim. Një strehim!... Sa qesharake. Në këtë vend me zakone patriarkale, ku njerëzit nuk kanë shumë kërkesa nga qytetërimi, pikërisht strehime nuk ka. Kasollet e vogla përgjatë bregut fluturojnë në ajër nga shpërthimet.

E megjithatë, me të kaluar të shtangurit e parë, burrat, ata shqiptarë të guximshëm, që nuk i tremben barutit, shpejt e mblodhën veten. Kanë rrëmbyer dyfekët, martinat, të vjetra ndoshta, por që vetëm duart e tyre dinë t'i përdorin. Rrëmujazi, por të vendosur, marrin për nga porti, ku disa mole, të prekur nga predhat me qitje të shkurtër, shfaqin tashmë rrënim të plotë.

Ushtarët e Madhërisë së Tij, Zotërisë Viktor-Emuanuelit III, zënë të zbarkojnë. Barka të mëdha mbushur dëng me ushtarë e armë moderne kërkojnë të arrijnë bregun. Disa plumba fshikullojnë

sipërfaqen e ujit përreth barkave. Dhe prej tyre, veç kur shpërthen zjarr breshërie që i bën barkat të luhaten, tronditur nga mitralimi. Më në fund, një barkë i afrohet ranishtës. Dhe menjëherë, pas strehimit të një kodrine ranore, ushtarët montojnë mitralozat e rëndë dhe tak-taku vdekjeprurës nis këngën e tij të kobshme, ndërkohë që një zjarr breshërie mushqetash të bersalierëve ka për tabelë qitjeje shqiptarët, që fshihen si të mundin prapa barkave të përmbysura apo prapa hekurave ku lidhen ballamarët.

Topat e rëndë vijnë bombardimin dhe nën goditjen e tyre trupat mund të vazhdojnë pa u dëmtuar zbarkimin. Janë në raportin njëqind italianë me një shqiptar. Lufta është tepër e pabarabartë, për më tepër që tashmë qitësit shqiptarë janë nxjerrë jashtë lufte. Metalurgjia e fuqishme italiane në formë predhash e armësh të blinduara ngadhënjën ndaj guximit të tyre të dëshpëruar dhe ndaj dyfekëve të vjetruar. Musolini mund të thotë sa të dojë nëpërmjet agjencisë Stefani se gjaku rrodhi rrëke dhe se trupat e tij pushtuan qytetet shqiptare, pavarësisht nga një mbrojtje heroike të ushtarëve shqiptarë. Kjo i shkoi për shtat aleatëve të tij.

Gjithçka mbaroi. Mbi rrënojat në tym, mund të vendoset tani flamuri italian për të festuar këtë ngadhënjim të lavdishëm armësh. Disa fëmijë qajnë mbi kufomat e nënave të tyre mbuluar në gjak të freskët, duke shikuar sy-shqyer ata ushtarë trimosha, me pendë gjithë ngjyra majë kape, që valëviten nga era e fitores.

101 të shtënat me topa, një ditë më parë paqësore këto për të lajmëruar ardhjen në jetë të princit trashëgimtar, Leka Zogut, pasuan gjëmimin e topave të Duçes për të lajmëruar një “jetë të lumtur, duke e çliruar popullin shqiptar nga zgjedha e një plutokrati!”...

Sepse kishte mbetur në Europën e mekanizuar në kulm edhe një ishull i vogël njerëzish me zakonet e tyre të lashta, që hanin bukën e thekrës, pinin qumështin e dhive, këndonin luginave baladat e të parëve të tyre!

Dhe tani u dashka që këta të marshojnë me hapin e patës, të këndojnë “Giovinezzan”, të përshëndesin fashistçe, të njohin uniformën e përhimtë të një populli vënë në rresht regimentesh...

Por, në fund të fundit, duhet thënë se as që u kërkuar ndonjëherë të merret mendimi i tyre.

Pas tradhtisë që Mbreti Zog i bëri vendit, duke e lënë nën mëshirën e gjerakëve të Musolinit, rinia revolucionare e Shqipërisë e bashkuar me Partinë Komuniste Shqiptare, filloi organizimin e rezistencës kundër pushtimit italian dhe për pesë vjet rresht luftoi deri në çlirimin e vendit në nëntor të vitit 1944. Shqipëria ishte vendi i parë në Evropë, i cili u çlirua nga Nazi-fashizmi, me forcat e veta, gjashtë muaj para përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Vetëm në Durrës u shënuar 75-vjetori i rezistencës popullore, antifashiste, italiane

Më 7 prill 2014, është përkujtuar në Durrës, 75-vjetori i Rezistencës Antifashiste Shqiptare dhe të gjithë atyre që dhanë jetën, duke luftuar në atë ditë historike për kombin. Veteranë, familjarë të dëshmorëve dhe disa drejtues të pushtetit vendor dhe prefekturës së qarkut kanë bërë homazhe pranë monumentit të Heroit të Popullit, Mujo Ulqinaku dhe kanë nderuar kujtimin e atyre që dhanë jetën për të ndalur pushtimin e vendit. “75 vjet më parë, Italia fashiste pushtoi Shqipërinë. Patriotët shqiptarë luftuan si mundën, pa mundën dhe ku mundën për liri dhe dinjtet. Ishim të varfër, por Shqipëria ishte një vend i pasur me gra dhe me burra idealistë dhe ata ishin krismat e para antifashiste në Europë. Nder dhe mirënjohje për të gjithë ata”, - tha Vangjush Dako. Më 7 prill të vitit 1939, Italia Fashiste nisi pushtimin e Shqipërisë nga porti i Durrësit, por ajo u prit me armë nga disa forcat shqiptare, por jo edhe nga shteti, i cili, shumë vjet më parë ishte kthyer në koloni italiane. Shqipëria ishte vendi i parë në Evropë, i cili u çlirua nga Nazi-fashizmi, me forcat e veta gjashtë muaj para përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Enrik Ago, Doktor i Shkencave Ushtarake

Enrik Ago u lind më 16.06.1965, në Bilisht, Korçë. Arsimitin e tij e ka kryer në: shkollën 8-vjeçare Bilisht, Shkollë e Mesme Ushtarake "Skënderbej". Ka vazhduar studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, Fakultetin e Specialiteteve, Dega Prapavijë, Tiranë; Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, Tiranë; Universiteti "F. S. Noli", Fakulteti Ekonomik, Dega Marketing, Korçë. Mban gradën ushtarake të "kolonelit" dhe gradën "Doktor i Shkencave". Njeh gjuhët anglisht dhe rusisht. Është dekoruar me titull Nderi "për shërbimin ushtarak", nga Shefi i SHP të FASH, me Dekoraten e Karrierës, nga Komandanti i Komandës Logjistike, me medalje Mirënjohje, nga Komandanti i Akademisë së FA-së, me Dekoraten "Për kontributin e dhënë", nga Shefi i SHP të FASH, "Mirënjohje", nga Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes.

Pas përfundimit të Shkollës së Lartë u emërua në batalionin e këmbësorisë Pilur, Himarë. Në vitin 1987-1990 u emërua shef Ushqimi dhe Stërviçje prapavije në Brigadën e Këmbësorisë, Himarë (Divizioni i Vlorës). Më pas kryen Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm. Pas përfundimit të saj emërohet në kontrollin financiar, Divizioni Vlorë. Në fillim të vitit 1993 transferohet shef Ushqimi në Divizionin e Korçës dhe në fund të atij viti deri në mesin e vitit 1994 në Drejtorinë e Inspektimit të Përgjithshëm, Ministria e Mbrojtjes...

Në gusht 2003 deri maj 2004 ka mbajtur pozicionin e shefit të seksionit logjistik në Komandën e Forcave Tokësore, në Tiranë e më pas deri në korrik 2005 në Qendrën e Modernizim-Standardizimit, Komanda e Doktrinave dhe Stërviçjes.

Më pas ka vazhduar punën tek Dega e Inspektimit të Përgjithshëm, Komanda Logjistike deri në maj 2007, dhe në këtë kohë emërohet Pedagog për Logjistikën dhe Personelin në Departamentin e Operacioneve, Akademia e Forcave të Armatosura e më pas në tetor 2016, shef i Grupit Taktik në Departamentin e Operacioneve.

Ka ndjekur Konferencat Planëzuese dhe Stërviçjet në "SEEBRIG", Bullgari, Rumani. Ka qenë pjesëmarrës në seminarin "Shkëmbim informacioni logjistik SHBA-Albania". Më pas ka marrë pjesë në Konferencat "Modernizimi dhe standardizimi i sistemeve e pajisjeve në FASH.

Punime Shkencore: Libri "Mbështetja Logjistike e Operacioneve"; Dispenca "Menaxhimi i Personelit në operacione", Akademia e FA-së; studimin "Modernizimi i Pajisjeve të Shërbimeve Fushore në FASH", Qendra e Modernizim-Standardizimit, Komanda e Doktrinave dhe Stërviçjes, studimin "Pajimet mbrojtëse antiplumb", Qendra e Modernizim-Standardizimit, KDS.

Dr. Enriku është autor i dhjetëra artikujve e studimeve shkencore ushtarake të botuar në median vendase dhe atë të huaj si: "Mendimi i Klauzeviçit për rolin dhe karakteristikat e komandantit", Revista Ushtarake, "Logjistika kombëtare e FASH në operacionet e NATO-s", Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, "Kontraktorët civilë në operacionet e FASH", "Rreziqet konvencionale ndaj NATO-s, çfarë ka ndryshuar dhe Implikimet mbi Shqipërinë dhe FASH", "Menaxhimi i Materialeve në strukturat e FASH, sipas Konceptit të Integruar të NATO-s", "Vizioni i rolit të Mbështetjes së Vendit Pritës të RSH për një kapacitet të plotë ndaj forcave të NATO-s", "Rëndësia e shërbimeve fushore në strukturat e FASH", "Pajimet mbrojtëse antiplumb.

Ndër aktivitetet shkencore ku ka marrë pjesë veçojmë: Konferenca e 3-të e Integritimit me NATO-n; Konferenca e 4-të e Integritimit me NATO-n; Konferenca shkencore ndërkombëtare mbi "Sistemet e Informacionit bazuar në rrjet (NBIS); Konferenca "Pranvera Arabe - konflikti më i ri në arenën ndërkombëtare" (MPJ - AFA - RTSH); Konferenca shkencore ndërkombëtare "Mbi rrjetin inteligjent dhe sistemet bashkëpunuese (INCoS/EIDWT)"; Sesion shkencor "Konsolidimi i kurrikulave të programeve Master, realitet dhe domosdoshmëri e kohës"; Konferenca shkencore "Zhvillimi i Doktrinës në një mjedis të ndryshueshëm të sigurisë dhe mbrojtjes"; Konferencë kombëtare "Shërbimi i kërkim-shpëtimit në RSH". Është bashkëpunëtor në hartimin e rregulloreve: "Doktrina Logjistike e FASH"; "Rregullore e Uniformës dhe Veshmbathjes në FASH"; Oponencë mbi Draft-Manualin "Kontrolli i Lëvizjes"; Reçensë për titull "Docent", etj. Është gjithashtu udhëheqës temash për tituj shkencor për shumë aplikantë.

Por si shprehet 'Skënderbegasi' Enrik Ago për shkollën ku u rrit dhe u formua?!

Ndihem krenar që kam studiuar në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej" një shkollë elitë, kujtimet e së cilës më kanë shoqëruar gjatë gjithë jetës. Pasi përfundova shkollën 8-vjeçare me rezultate shumë të mira në vendlindje, Bilisht, rrethi Korçë, kisha dëshirë të vazhdoja shkollën e mesme dhe më pas shkollën e lartë. Në ato vite nga Seksioni i Arsimit të Rrethit për nxënësit që mbaronin me rezultate të larta, ofroheshin bursa studimi për shkollë të profilizuara në fusha të ndryshme. Midis këtyre bursave profili ushtarak ishte më i kërkuari, por përveç notës mesatare vlerësosheshin dhe disa aspekte të tjera lidhur me gjendjen shoqërore të familjes, etj. Pas disa procedurave nga Këshilli i Qytetit dhe Degës Ushtarake në Korçë, mu dha e drejta e studimit në Shkollën "Skënderbej".



Në 25 gusht 1979, së bashku me nxënësit e rrethit të Korçës u paraqita në ambientet e shkollës "Skënderbej", me mërztijen e shkëputjes nga familja, shoqëria dhe vendlindja, duke patur parasysh dhe moshën, vetëm 14 vjeç. Por kjo ishte e përkohshme, në shkollë gjetëm një ambient mikpritës dhe dashamirës, si nga eprorët ashtu dhe nga skënderbegasit në vitet para nesh.

Kështu nisa rrugën e shkollimit dhe formimit tim të përgjithshëm dhe ushtarak, në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej", një shkollë e cilësuar në të gjithë vendin për nivelin mësimor mjaft të lartë dhe me një trupë pedagogjike ndër më të mirat nga shkollat e mesme. Shkolla në atë kohë kishte programin mësimor të gjimnazit, si dhe organizimin ushtarak.

Personeli pedagogjik ishte civil, i njëjtë me gjimnazet e Tiranës, i cili ishte i ndarë nga aktiviteti ushtarak, që zhvillohej para dhe pas përfundimit të procesit mësimor dhe menaxhohej nga personeli ushtarak komandues.

Kujtoj me respekt dhe mirënjohje të thellë mësuesit e mi që më dhanë mësim për një kohë të gjatë: mësuesi i matematikës Shkëlqim Dervishi, e fizikës Marjeta Berati, e rusishtes Hamide Daja, e marksizmit Drita Karoli, e letërsisë Fortunata Mullaj, e gjeografisë Sanije Tabaku, e historisë Afërdita Çepani, i kimisë Fiqiri Shtëpani, i astronomisë Skënder Shkupi, dituri makinash Fatmir Sukaj, i fizikulturës Aleksandër Dheri, etj.

Kujtoj me respekt komandantët që na edukuan me normat dhe rregullat ushtarake, oficerët: Sami Murra, Vladimir Mema, Kastriot Ago, Naum Dama, Shpëtim Spaho, Aqif Muça, Përparim Celibashi si dhe drejtuesit e lartë të shkollës Mikail Vaso e Virgjil Janku.

Kujtoj shokët e mi të klasës me të cilët kaluam katër vjet si

të ishim vëllezër, Krahas shokëve të klasës, kujtoj se kishim një komunikim dhe shoqëri të mirë edhe me shokët e klasave të kompanisë sonë (e dyta), si dhe me klasat e dy kompanive të tjera. Një kënaqësi e veçantë për mua ka qenë prania në shkollë i një numri të konsiderueshëm skënderbegasish nga zona e Korçës. Djem të shkëlqyer në të gjithë aspektet, në mësim, në sjellje dhe marrëdhëniet me njeri-tjetrin.

Shkolla "Skënderbej" kishte aktivitet specifik në pikëpamje mësimore, edukuese dhe ushtarake, në krahasim me gjithë shkollat e tjera të mesme që kryenin bashkëmoshatarët tanë, me të mirat dhe risitë e veta, por dhe me mjaft vështirësi dhe privacionet të moshës. Aktiviteti 24 orësh përfshinte kryesisht procesin mësimor, orët e studimit pasdite dhe para mësimit, detyrimet e programuara ushtarake jashtë mësimit, orarin e veprimeve, rregullin ushtarak në territor, fjetina, klasa, mensa, etj.

Gjithashtu viti mësimor përfshinte dhe punët prodhuese, të cilat i kryem në Lekaj - Kavajë dhe Radostimë - Fier, aksionet e ndryshme në ndihmë të pushtetit lokal, fushimet në Karpen dhe Voskopojë, aktivitete kulturore e sportive etj. Gjithsesi gjithë këto veprimtari na shërbyen më së miri për formimin arsimor, kulturor, kalitjen e vullnetit dhe karakterit, pasi rruga e nisur në profesionin e oficerit nuk do të ishte e lehtë. Mbresa të pashlyera më kanë lënë zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive, që zhvilloheshin në bashkëpunim me gjimnazet e Tiranës, ku duhet të theksoj se shkolla jonë radhitej pothuajse gjithmonë në vend të parë.

I jam mirënjohës kësaj shkolle që më mësoi dhe më edukoi dhe më krijoi bazën e formimit tim, e ndryshme dhe e spikatur me vlera të shumta pozitive shoqërore, miqësore dhe atdhedashurie.

Kapedan Kajo Babjeni

Nën drejtimin e Kajo Babjenit, 800 burra lidhën besën e çliruan Gorën e Pogradecin

Më 28 korrik të vitit 1912, në vendin e quajtur Guri i Kamjes, çetat e Gorës dhe Mokrës, me Flamurin e Shqipërisë, u bashkuan për të luftuar Xhonturqit dhe për të çliruar Pogradecin... Xhonturqit, me shtypjen e kryengritjes së vitit 1905, e me radhë më 1906-1909-1910-1911-1912, nuk arritën të shuanin qëndresën e popullit Shqiptar. Përvoja kishte treguar se fitorja e Lëvizjes Kombëtare mund të sigurohej vetëm duke bashkuar forcat popullore në një kryengritje të vërtetë.

Kërkesat ishin: Për amnistinë e përgjithshme, për lirinë e plotë të Arsimit Kombëtar mbi bazën e alfabetit latin, krijimin e një administrate me nëpunës shqiptar dhe përdorimin e të ardhurave për zhvillimin ekonomik dhe kulturor të popullit shqiptar.

Përveç pushtimit osman, Krahinat e Gorës, Mokrës dhe Oparit, kërcënoshin nga orvatjet e shteteve fqinjë, për aneksimin e trojeve. Gora dhe krahinat e tjera, mundën t'i bënin ballë burgosjeve, internimeve e plaçkitjes nga qeveritarët turq. Synimet e pushtuesve ishin, copëtimi i Shqipërisë, duke u mbështetur, me nënshkrimin e Traktatit të Shën Stefanit, më 1878, ku mjaft troje Shqiptare, do t'u aneksoheshin shteteve fqinjë, si Maqedonisë, Jugosllavisë, Greqisë etj... Këto copëtime përfshinin Pogradecin dhe krahinën e Gorës deri në Voskopojë.

Vala e protestave kundër kësaj padrejtësie ishte e fuqishme. Populli i Gorës u organizua dhe u ngrit me armë në dorë. Këtu ishte dhe ndikimi i Degës së Lidhjes të Prizrenit, që sapo ishte formuar në Pogradec... Në këtë situatë, shumë djem gorarë dezertuan nga ushtria osmane, e qëndronin maleve. Po kështu, shumë fshatarë, sa mësonin që në fshat vinin taksambledhësit e zyrtarët e administratës turke, linin shtëpitë e deri dhe qetë e mbrehur në arë dhe dilnin me armë në mal... Në krahinat e Gorës, Mokrës e Oparit, situata po evoluonte çdo ditë e më shumë. Tani po e zinte vendin protesta me armë, nga individë të quajtur grupe kaçakësh.

Kapedani Kajo Babjeni

Lëvizja e kaçakëve, pas Lidhjes së Prizrenit, u bë një rezistencë e rëndësishme në Gorë, që me veprimet e tyre luftarake, zunë vend në histori dhe do të kujtohen brez pas brezi. Ata kundërshtonin regjimin për mospagimin e taksave, mos zbatimin e urdhrave të qeveritarëve turq, godisnin me armë koshadhet e turkut. Këto veprime kryeshin nëpërmjet çetave me Kapedan Kajo Babjenin në krye, Shahin Matrakun nga Popçishtu i Oparit dhe Ismail Dërdusha.

Tre kapedanët bashkëpunonin ngushtë me njeri-tjetrin. Synimi ishte çlirimi i Gorës e mbrojtja e saj nga synimet e pushtuesve të huaj... Çeta e Kapedan Kajo Babjenit, e kishte shtrirë veprimtarinë luftarake në Gorë, Opar, Mokër, Korçë e Pogradec. Ai kishte treguar vendosmëri e trimëri, pjekuri të madhe, cilësi këto që i shërbyen shumë në kohën që drejtonte çetën, e cila mori dhe emrin e tij.

Prandaj, fshatrat e Gorës, Mokrës dhe Oparit, rrëmbyen



armët dhe u bashkuan me çetën e Kajo Babjenit, për të mbrojtur tokën amtare. Kapedan Kajua, ishte mjeshtër i dyfekut, luftëtar e komandat i mirë e i zoti, por kishte edhe vështrim e horizont politik. Njihej për karakter të fortë burrëror, për urtësi, besnikëri ndaj popullit e Atdheut. "Për një qëllim të shenjtë kemi rrëmbyer armët". Kur Kajo kishte hyrë në Lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, më 1905, bënte pjesë në Komitetin për Çlirimin Kombëtar të Korçës...

Qëndresa e çetave të Gorës ndaj administratës osmane e synimeve të shovinistëve maqedonas, po merrte përmasa të mëdha. Përveç çetave, armatosej dhe mbarë popullsia. Në Gorë po vinin patriotë nga Korça, Kolonja, Pogradeci. Gora konsiderohej si bazë e sigurt e lëvizjes atdhetare, si strehë për luftëtarët e çetave patriotike të Rilindësve. Kjo e detyroi

administratën osmane që në Gorë, të mos shkelte këmba e osmanlinjve. Lindi nevoja e vetëqeverisjes, nga njerëz patriotë e të devotshëm.

Komiteti i Gorës

Në pranverën e vitit 1906, në fshatin Dërdush të Gorës, u bë një mbledhje e gjerë me përfaqësues nga e gjithë krahinat. Aty u propozua dhe u zgjodh një Komitet i Fshehtë Krahinor me 12 anëtarë. Kryetar u zgjodh Kapedan Kajo Babjenji.

Detyra e këtij komiteti ishte për popullarizimin e lëvizjes kombëtare, bashkëpunimin midis çetave, si çeta e Çerçiz Topullit, etj. Luftëtarët e këtyre çetave nuk mbanin vetëm pushkë e fishekë por në çantat e tyre mbanin dhe Abetaren Shqipe. Në vjeshtën 1907, në fshatin Zbogj, u organizua një mbledhje e zgjeruar, me çetat patriotike të Çerçiz Topullit, Spiro Ballkamenit, Qemal Panariti, Kajo Babjenit e Ismail Dërdushës. Qëllimi ishte "shtimi i çetave, bashkëpunimi midis tyre e krahinave". Ky u quajt Kuvendi i Zbogjit. Kjo e shqetësoi shumë administratën turke dhe e detyroi të tërhiqte 35 xhandarë nga Gora e i çoi në Pogradec. Kjo shënoi dhe çlirimin Gorës nga osmanlinjtë. Menjëherë xhonturqit filluan arrestimet e burgosjet.

Në verën e vitit 1909, në fshatin Babijenj, rrethuan Kajo Babjenin me çetën e tij dhe i bënë thirrje të dorëzohej. Por Kapedani u përgjigj me pushkë. I gjithë fshati luftonte. Se trimat, nuk i dorëzohen të gjallë armikut. Kapedani del nga shtëpia duke shkelur mbi kufomat e turqve që kishin ngelur nën strehët e shtëpisë, çan rrethimin e del pa asnjë dëmtim. Populli i këndon "Ky Babjenji në një breg/

Ndizet zjarr, kërcet dyfek/, O Kajo trim i mirë/ Ç'e nderove Shqipërinë". Autoritetet xhonturke kishin filluar të merrnin masa të rrepta kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Ata arrestuan në Korçë një numër të madh patriotësh. Çetat e Spiro Ballkamenit dhe Qamil Panariti, më 29-30 korrik 1911 çanë rrethimin e turqve në Orman-Çiflig.

Çlirimi i Pogradecit

Çetat në Gorë e Mokër ishin të ngritura. Ato udhëhiqeshin nga Kapedanët Kajo Babjenji, Ismail Dërdusha e Xhelo Selca. U bë koordinimi i veprimtarisë së tyre. Për këtë Komiteti Krahinor, mori masa dhe bëri riorganizimin. Ky takim u zhvillua në fshatin Strelcë, në verën e vitit 1912 dhe iu vu emri Komision Krahinor. Kryetar u zgjodh Xhelo Selca. Kryengritja e përgjithshme kundër turqve kishte filluar në vitin 1912 në të gjithë Shqipërinë.

Në jug Themistokli Gërmenji forcoi lidhjet me kapedanët Kajo Babjeni, Sali Butkën etj. Komisioni Krahinor, më 26 korrik 1912, me rreth 350 burra të armatosur nga gjithë krahinat e Gorës mblidhen tek Guri i Kamjes. Aty u mblodhën edhe shumë atdhetarë nga Mokra, nga Pogradeci, Korça etj., me qëllim çlirimin e Pogradecit. Në këtë takim ishin Kajo Babjeni, Xhelo Selca, Telha Senishti, Feta Goca, Feim Zbogji, Mehmet Velçani, Adem Çezma etj. Të gjithë diskutuan dhe caktuan datën e sulmit për të çliruar Pogradecin.

Çetat e Gorës u bashkuan tek Guri i Kamjes, në lartësinë 1461 m tek "Lisi i Gorarëve" dhe u organizuan për luftë kundër forcave turke që kishin pushtuar Pogradecin. Pas organizimit të çetave të Gorës u bë dhe organizimi i 7 çetave të Mokrës. Më 28 korrik 1912 u bashkuan në fshatin Potgozhan e zgjodhën një komandë prej 12 vetash. Komandant ishte Kajo Babjenin. Pra 28 korriku i vitit 1912 ishte evenimenti ku çetat patriotike të Gorës e Mokrës tek 'Lisi i Gorarëve' ngritën flamurin Kombëtar... Organizimi u bë i plotë në të gjithë elementët luftarakë. Çetat e kishin siguruar vetë armatim-municionin. Ishin 800 luftëtarë.

Detyra ishte: "Çlirimi i Pogradecit nga xhonturqit dhe bllokimi i ardhjes së ushtrisë serbe nga Ohri. Drejtimi i sulmit mbi Pogradecin u bë nga Kajo Babjeni... Pas disa luftimeve sporadike në kala dhe në rrethinat, garnizoni turk e lëshoi Pogradecin. Pas çlirimit të qytetit Kajua theksoi: "Lirinë e gëzofshi, por mendjen mos e flini, gjumi mos u zërë. Armiqtë greke e sllavë nuk do na lënë kohë të rruajmë mjekrën".

Çdo 28 korrik, banorët e Gorës e zonave fqinje, kudo që të jenë, mblidhen tek Guri i Kamjes dhe përkujtojnë ngjarjen e rëndësishme.



(Foto e rrallë e Kajo Babjenit me çetën e tij dhe oficerët austriakë, viti 1914)

AI-ja në klasa: E ardhmja tashmë është këtu

Përdorimi i inteligjencës artificiale (AI) në klasë shpesh sjell imazhe të robotëve që mësojnë fëmijët. Nxënësit ndërveprojnë me softuer me zë të butë për të kryer gjërat. Ose, softuerët dhe makineritë që zëvendësojnë mësuesit dhe edukatorët. Zhvillimet aktuale përmbajnë pak nga të gjitha këto stereotipe, por në mënyra që përfitojnë si nxënësit ashtu edhe mësuesit dhe e bëjnë arsimin shumë më të përgjegjshëm ndaj nevojave të të gjithëve. Studentët e sotëm do të punojnë në një të ardhme ku AI është realiteti, kështu që është kritike që mësuesit të përfshijnë dhe njohin të studentët me teknologjinë.

Për të kuptuar më mirë të ardhmen e AI-së në klasë dhe se si do t'i ndihmojë mësuesit dhe studentët, është e rëndësishme të shihet se si teknologjia arsimore e bazuar në AI, po përdoret në shkolla dhe institucione arsimore tani.

Mësimi në distancë është një sfidë

Pandemia i kapi të gjithë të papërgatitur - veçanërisht mësuesit. Mbajtja e studentëve të angazhuar është e vështirë kur gjithçka me të cilën duhet të punosh është një ekran. Një zgjidhje për këtë është përdorimi i Rev Zoom Live Captions për të kthyer me saktësi fjalimin në tekst. Shkalla e lartë e saktësisë së shërbimit të titrave me AI rrit aksesin dhe e bën përmbajtjen e ekranit më të lehtë për t'u kuptuar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme me studentët që janë të shurdhër ose me vështirësi në dëgjim, kur shpejtësia e lidhjes me internetin nuk është njësoj e madhe për të gjithë në një telefonatë Zoom, ose kur jo të gjithë ndajnë të njëjtën gjuhë të parë.

AI-ja në arsim është tashmë këtu

Përpara pandemisë, disa shkolla dhe institucione arsimore në Australi po përdornin tashmë mjetet e AI-së në klasë për të ndihmuar në përmirësimin e rezultateve të të nxënësve për studentët e tyre. Si teknologjia e edukimit të realitetit virtual (VR) dhe realitetit të shtuar (AR) përdor inteligjencën artificiale për të krijuar mjedise mësimore më gjithëpërfshirëse. Përvoja e të mësuarit ndryshon në mënyrë dramatike kur studentët mund të ndërveprojnë me mjedisin që po studiojnë. Përveç kësaj, mjetet interaktive të të mësuarit i lejojnë studentët të bashkëpunojnë në projekte arsimore edhe kur nuk janë në të njëjtin vend, duke bërë të mundur mësimin në kohë reale.

Përdorimi i teknologjisë së fjalës në tekst dhe platformave të të mësuarit të mbështetur nga AI-ja ndihmon në pasurimin e të nxënësve të studentëve dhe mund ta bëjë shumë më të lehtë punën e mësuesve. Përfitimet reale të përdorimit të inteligjencës artificiale në klasë, megjithatë, qëndrojnë në të ardhmen shumë të afërt të arsimit. Zhvillimet që ka të ngjarë të shohim rrotullohen rreth aftësive thelbësore të ofruara nga inteligjenca artificiale: Personalizimi, Automatizimi dhe Adaptim.
